

D E K R E T
Nr.1440, datë 4.4.1996

PËR TRAJTIMIN E BANESAVE SHETËRORE TË PAPRIVATIZUARA

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Banesat shtetërore që nuk janë privatizuar deri në datën 31 dhjetor 1995 sipas ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe që nuk janë subjekt i ligjit nr.7658, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, kalojnë në administrim të organeve të pushtetit lokal në bashki e komuna, sipas vendndodhjes së banesës.

Neni 2

Këshillat e bashkive ose të komunave, në varësi nga vendndodhja e këtyre banesave, do të vendosin për privatizimin e tyre sipas kriterëve të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe ndryshimeve që i janë bërë me ligjin nr.7828, datë 1.6.1994.

Neni 3

Banesat shtetërore, sipas neneve 1 dhe 2 të këtij ligji, deri në privatizimin e tyre, do t’u nënshtrohen tarifave të qirasë sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 4

Të ardhurat nga privatizimi i këtyre banesave, si dhe të ardhurat nga qiraja, do të derdhen në numrin e llogarisë së bashkive a të komunave, në varësi nga vendndodhja e këtyre banesave.

Këto të fundit do të kenë edhe detyrimin për mirëmbajtjen e banesave të paprivatizuara.

Neni 5

Organet përkatëse për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, në bashkëpunim me bashkitë ose komunat, bëjnë regjistrimin në bashkëpronësi në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi të banesave të privatizuara sipas ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”.

Neni 6

Në ligjin nr.7828, datë 1.6.1994, nenet 4, 6 dhe 7, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë dekret, shfuqizohen.

Neni 7

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha